

### 3. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË VEND

**(14) Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2018, ekonomia u rrit me 4.5%<sup>13</sup> në terma vjetorë.** Kontributi kryesor erdhi nga sektorët e prodhimit dhe të shërbimeve, ku dallojnë degët: "industri, energji dhe ujë", "tregti, transport, akomodim dhe shërbim ushqimor", dhe "ndërtim". Rritja e kërkesës agregate u mbështet nga zgjerimi i konsumit final të popullatës dhe formimi i kapitalit fiks, në kushtet kur konsumi final i qeverisë ka ardhur në rënie përgjatë periudhës. Në kahun frenues ka ndikuar edhe zgjerimi i deficitit të llogarisë korrente, kryesisht rrjedhojë e zgjerimit të tepricës negative në llogarinë e të ardhurave parësore. Në tregun e punës, norma e papunësisë vijoi prirjen rënëse që prej dhjetorit 2015, duke shënuar në fund të vitit nivelin prej 12.3%<sup>14</sup>. Për periudhën afatshkurtër, pritshmëritë mbi nivelet e punësimit mbeten kryesisht pozitive.

**(15) Politika monetare ruajti qëndrimin lehtësues gjatë periudhës.** Ndonëse rezultatet e analizave ekonomike dëshmojnë për zhvillime pozitive në aktivitetin ekonomik, në punësim dhe në besimin e agjentëve të ekonomisë, ende nuk ka një reflektim të tyre në vlerat e inflacionit. Kështu, në dhjetor të vitit 2018, inflacioni vjetor shënoi nivelin 1.8%, pa ndryshim kundrejt një viti më parë<sup>15</sup>. Ecuria e inflacionit ka reflektuar goditjet e përkohshme nga kahu i ofertës dhe efektin frenues të mbiçmimit të kursit të këmbimit të lekut. Sidoqoftë, Banka e Shqipërisë pret që efekti i zhvillimeve pozitive ekonomike të shtrihet edhe në periudhat në vijim, duke bërë që vlerat e inflacionit të lëvizin drejt nivelit objektiv prej 3% në afatin e mesëm.

**(16) Politika fiskale ka ruajtur qëndrimin e saj konsolidues.** Deficiti buxhetor i vitit 2018 shënoi vlerën 27 miliardë lekë, duke qenë rreth 4 miliardë lekë më i ulët se një vit më parë. Në ngushtimin vjetor të vlerës së deficitit buxhetor, ndikoi rritja e të ardhurave buxhetore me 4.4% kundrejt rritjes prej 3.1% të shpenzimeve buxhetore. Shpejtësia e krijimit të deficitit buxhetor ishte më e lartë në tremujorin e fundit të vitit, duke evidentuar sërish nevojën për shpërndarjen e shpenzimeve, veçanërisht të atyre kapitale, në përputhje me objektivat dhe në mënyrë konsistente përgjatë vitit financiar.

**(17) Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2018, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me zgjerim të mjeteve valutore për rreth 274 milionë euro.**

<sup>13</sup> Kjo është vlera e publikuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT) në datën e dërgimit të këtij raporti për shqyrtim nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Prej asaj date, INSTAT-i ka rishikuar vlerën e rritjes ekonomike të tremujorit të tretë të 2018, në 4.66%, dhe ka publikuar edhe normën e rritjes ekonomike të tremujorit të katërt të vitit 2018, prej 3.1%. Vlerësohet se këto vlera nuk sjellin ndryshime të rëndësishme në analizën e raportit.

<sup>14</sup> Norma e papunësisë shënonte nivelin prej 12.4% në T2-2018, dhe 12.2% në T3-2018.

<sup>15</sup> Në T3-2018 dhe T4-2017, vlerat e inflacionit ishin përkatësisht 2.2% dhe 1.8%.



Deficiti i llogarisë korrente u zgjerua me 17% në terma vjetorë, në nivelin 364 milionë euro, në sajë të thellimit të deficitit të mallrave me 8% dhe ngushtimit të tepricës pozitive në llogarinë e të ardhurave dytësore me rreth 6%. Tek kjo e fundit, të ardhurat nga emigrantët u vlerësuan në 170 milionë euro, me një rënie prej 2%. Teprica pozitive e llogarisë së shërbimeve u tkurr lehtë, me 1.3%, ndërsa teprica pozitive e të ardhurave parësore pothuaj u dyfishua. Teprica e llogarisë kapitale dhe ajo e llogarisë financiare, mbuluan plotësisht deficitin e llogarisë korrente. Në llogarinë financiare, flukset hyrëse (rritje e detyrimeve financiare me botën) u rritën me 29% dhe shënuan 541 milionë euro, të ndara pothuaj në mënyrë të barabartë mes flukseve në formën e investimeve të huaja direkte dhe atyre në formën e detyrimeve financiare. Përgjatë vitit 2018, vlerësohet që deficiti i llogarisë korrente u ngushtua me 0.7%, në nivelin 860 milionë euro, ndërsa investimet e huaja direkte u rritën me rreth 14%, ose me 1,022 milionë euro.

